

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga Kavaja në Tiranë e Durrës/ Zbardhen 6 vjedhje automjetesh, arrestohen 2 persona
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/28/nga-kavaja-ne-tirane-e-durres-zbardhen-6-vjedhje-automjetesh-arrestohen-2-persona/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 11:17:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	28 shtator 2026, 11:14:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 28 shtator 2026, 11:13:00 UTC → 28 shtator 2026, 11:15:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2d2472619acd787fb3b006c88c9af1a01b5915569ae56574d271608edafd2e69
TEKSTI	c88bf725207db9f7b8f95e7cafb1bac7ee405125737b3233b32dff1d709acfc
PAMJA	cefe534d1215194c1aee408155f54e9238c29cb5dbae5c55eebe66416920af52

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	636e12e6797d869008835262689e77ea2603208daf6d5d7a658ab5279b695bfe
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b4355a68894c65a63b1e90d1f962746a91a9c18b00f6b0772c3894db0f3539f0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/636e12e6797d869008835262689e77ea2603208daf6d5d7a658ab5279b695bfe>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET LAJME TË FUNDIT

Nga Kavaja në Tiranë e Durrës/ Zbardhen 6 vjedhje automjetesh, arrestohen 2 persona

28/09/2026 13:14



Një operacion i koduar "Cooperation" është finalizuar nga Policia në Kavajë, duke çuar në arrestimin e dy personave të dyshuar për një seri vjedhjesh automjetesh në disa qytete të vendit.

Në kuadër të hetimeve janë zbardhur gjashtë raste të vjedhjeve, ndërsa dy të dyshuarit, me precedent të mëparshëm penalë, u kapën teksa qarkullonin me një automjet të vjedhur.

Sipas Policisë, gjatë hetimeve është dokumentuar dyshimi se ata kanë vjedhur automjete në Kavajë, Durrës dhe Tiranë, ndërsa njëri prej rasteve në kryeqytet dyshohet se është kryer nën kërcënimin e thikës. Gjithashtu, njëri prej të arrestuarve dyshohet se ka vjedhur me dhunë xhiron ditore të një pike karburanti në Bulqizë.

Gjatë operacionit dhe periudhës hetimore janë sekuestruar automjete, targa, çelësa, telefona celularë, veshje dhe mjete që dyshohet se janë përdorur për hapjen e automjeteve. Hetimet vijojnë për dokumentimin e rasteve të tjera të mundshme, ndërsa materialet procedurale i janë referuar Prokurorisë për veprime të mëtejshme.

"Kavajë/Finalizohet operacioni i koduar "Cooperation", zbardhen 6 raste të vjedhjes. Kapen duke qarkulluar me një automjet të vjedhur dhe vihen në pranga 2 autorët e dyshuar, me precedent të theksuar për vjedhje dhe kundërshtim të punonjësve të Policisë.

Gjatë operacionit dhe gjatë periudhës hetimore janë sekuestruar 4 automjete, 3 targa dhe 3 çelësa automjetesh, 4 celularë, veshje të përdorura gjatë kryerjes së vjedhjeve dhe mjete për hapjen e automjeteve.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Kavajë, si rezultat i hetimeve të kryera për zbardhjen e vjedhjeve, identifikimin dhe kapjen e autorëve, organizuan dhe finalizuan në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Durrës, operacionin e koduar "Cooperation".

Në kuadër të këtij operacioni u arrestuan shtetasit L. R., 37 vjeç dhe A. H., 32 vjeç, të dy banues në Tiranë. Këta shtetas ishin shpallur në kërkim pasi më datë 24.09.2026, kanë vjedhur një automjet në Kavajë dhe më pas janë larguar, pasi janë ndihmuar nga shtetasit L. D. dhe B. S. (të arrestuar), të cilët kanë kundërshtuar me dhunë punonjësit e Policisë.

Gjatë operacionit të koduar "Cooperation", shërbimet e Policisë kanë lokalizuar automjetin me të cilin qarkullonin këta shtetas dhe i kanë bërë shenjë për ndalim, por ata nuk janë bindur dhe kanë kundërshtuar veprimet e punonjësve të Policisë.

Nga verifikimet rezultoi se automjeti me targa të huaja me të cilin qarkullonin këta shtetas ishte i vjedhur.

Kryesore



Presidenca zbardh mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare dhe arkivon Vlora Hysenin: Drejtësia të bëjë punën e vet, çështjet individuale...

12:39

Merr flakë lokali në Athinë ku u vra Pëllumb Islami, dyshohet për zjarrvënien të qëllimshme

08:29

Sot Konferenca Ndërparlamentare, Rama, Peleshi dhe Schieder të pranishëm. Në fokus zgjerimi i BE dhe integrimi i Shqipërisë

08:25

Kuvendi i Kosovës miraton deklaratën për ish-krerët e UÇK-së: Kundërshtojmë aktgjykimin e padrejtë

12:58

Shënoi në Wembley dhe udhëhoqi Spanjën, Lamine Yamal kërkon kurorën e futbollit botëror. Katalanasit këmbëngulin për "Topin e Artë"

09:37

Më të lexuarat

Kreshnik Spahiu shpërthen ndaj burrave shqiptarë: Janë injorantë, vishen si arabë dhe jeta u vërtitet nga lavazhi te garazhi

E PLOTË/ "Si ka mundësi që nuk e dija?", mesazhi i Ramës pas akuzave të SPAK për zyrtarët pranë tij: Kam fajet e mia, por jam këtu për të bërë histori e jo pasuri

Pas paralajmërimit, Aleksandar Vučić jep dorëheqjen si President i Serbisë

Exclusive/ Nga dhoma e hotelit me Guardiolen te 15 vite si drejtor i Lazios dhe aventura te Milani, Igli Tare në një rrëfim ndryshe

Ekskluzive/ Ministri Ferit Hoxha avancoi me rokadën e ambasadorëve, Denion Meidani shkon në Prishtinë, Petrit Malaj në Shkup

Asnjë shtrëngim duarsh, kokat ulur dhe shirita të zinj, Irlanda e kthen ndeshjen me Izraelin në një deklaratë simbolike

"Më ka ndaluar shërbimi sekret", ish-deputeti i PD flet për Top Channel pasi iu refuzua hyrja në RMV: Më nxorën një fletë, kërkuam që...

Greqia shkakton 'tërmet' në Gjermani, mposht 4 herë kampionët e botës

Detaje/ Mbledhja e Këshillit të

shtetas ishte i vjedhur.

Nga hetimet dyshohet se këta shtetas, gjatë muajit shtator, në bashkëpunim me njëritjetrin, kanë vjedhur 3 automjete, në Durrës, ndërsa në Tiranë kanë vjedhur 2 automjete, në njërin rast duke kanosur me thikë, pronarin e automjetit.

Gjithashtu, dyshohet se më datë 17.09.2026, shtetasi A. H. ka vjedhur me dhunë një shumë parash (xhiron ditore), në një pikë karburanti, në Bulqizë.

Vijojnë hetimet për zbardhjen e vjedhjeve të tjera që mund të kenë kryer këta shtetas. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për veprime të mëtejshme”, shkruan policia.

Top Channel

I Aktualitet »



“Kishte pajisje të vjetra elektroshtëpiake”/ I moshuari u gjet i karbonizuar në banesën e djegur në Fier, policia zbardh shkaqet e ngjarjes së rëndë

28/09 12:36



Operacioni “Transit”, arrestohet 39-vjeçari që transportonte 16 emigrantë drejt Malit të Zi

28/09 12:35




Banorët e fshatit Burimas të Maliqit sërish në protestë për projektin e furnizimit me ujë të Zvezdës, bllokojnë rrugën. I moshuari pëson gjendje të fikëti

28/09 12:18



“A do më lini ta drejtoj këtë Komision?”/ Manja i tërheq vërejtje Blushit, ndërpret mbledhjen pas përplasjes me Mziun

28/09 12:10



Detaje/ Mbyllet mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare pas 90 minutash diskutime, i pranishëm edhe kreu i SPAK

28/09 11:48



Shtyhet seanca për vrasjen e Egli Progës, të akuzuarit kërkojnë gjykim të shkurtuar

28/09 11:40

I Lajme »



Alarm i kuq në Meksikë, uragani “Polo” pritet të prekë tokën të hënën mbrëma

27/09 22:14



“Askush dhe asgjë s’do më ndalë”, Rama u përgjigjet kundërshtarëve: Kujtojnë se kanë ‘bombën çudibërëse’ që do më hedhë përtokë, hidheni mëngjes, drekë e darkë

27/09 16:05



“Asisti më i bukur në karrierë”/ Hysaj flet për të ardhmen: I kam kërkuar presidentit Duka kontratën e veçantë

26/09 23:48



Nga mbrojtja e rritja ekonomike te lufta kundër grupeve kriminale transnacionale, Ambasada Amerikane tregon prioritetet e ambasadorit të ri të Trump në Tiranë

26/09 15:54



VIDEO/ Ish-kreu i SHISH, Vlora Hyseni del nga GJKKO, iu komunikua masa e sigurisë “arrest në shtëpi”. Nuk flet për mediat

24/09 14:25



Presidenti Begaj mbledh drejtuesit e sigurisë në Presidencë, takim me ministrin e Brendshëm, drejtorin e Policisë dhe kreun e komanduar të SHISH

24/09 13:19

Na ndiqni:



Sigurisë Kombëtare pas 90 minutash diskutime, i pranishëm edhe kreu i SPAK

Sot Konferenca Ndërparlamentare, Rama, Peleshi dhe Schieder të pranishëm. Në fokus zgjerimi i BE dhe integrimi i Shqipërisë

Top Channel

@topchannelalbania

@tchbreakingnews

Top Channel

I Video »



Top News – Zjarre njëri pas tjetrit në Gjirokastrë/ Digjet plotësisht një makinë dhe një kasolle



Top News- Vrasja e Egli Progës / Kërkohej gjykim i shkurtuar, seanca shtyhet në tetor



Top News – Mashtrimi me IA/ Dy të rinjtë tentuan 100 mijë euro, kapen në flagrancë



Top Channel/“Mos bëni zhurmuesin kur flas”, Manja i fik mikrofonin Mziut: S’më ofendon dot mua në...



Top Channel/ Manja përplasje me opozitën te ‘Ligjet’: Ju iku treni, doni të kapni lepurin tani



Top Channel/ “Kockën tuaj do hani”, debat Strazimiri-Manja: Aman, pash zotin mos u shqetësoni për ne

Lajme

Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

Sport

Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A
Shumësportësh
Sport Gossip

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

Big Brother VIP
Për’puthen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

Top Channel

Rreth Top Channel
Kontakt
Bileta – Portokalli
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.